



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 2019 prot

Peshkopi më 14.06.2021

Lenda: Kerkese per bashkepunim  
Drejtuar :Kryetarit te Bashkise ne detyre  
Shkelqim Murrja  
Drejtore Ekonomike te Bashkise Diber

Keshilli Bashkiak Diber, ka publikuar nje pyetesor per projekt buxhetin 2022-2024. Ky pyetesor jep informacion per menyren se si jane shpenzuar parate, dhe i jep mundesi qytetareve qe te rekomandoje sherbimet prioritare per vitin 2022.

Informacioni bazohet mbi te dhenat e raportit te monitorimit dhe zbatimit per vitin 2020.

Nga rezultatet e sondazhit vihet re nje pjesemarrje e qytetareve nga te gjitha njesite administrative, te cilat kane renditur sherbimet prioritare.

Gjithsesi keto pergjigje jane vetem paraprake, pasi ky pyetesor eshte i vlefshem edhe per muajt ne vazhdim.

Prioritetet e komunitetit ne lidhje me projekt buxhetin 2022, dhe ate 2022-2024 jane:

- Mbeshtetje per zhvillim ekonomik
- Arsim profesional
- Arsim I mesem I pergjithshem
- Sport dhe argetim
- Ndricim rruges etj

Per rrjedhoje do te ngrinin ne vemendjen tuaj konsiderimin e financimit te ketyre funksioneve ne PBA qe popergatisni gjate kesaj periudhe.

Raportin e plote te pyetesorit po ja bashkengjisim kesaj shkrese.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin,

Kryetar I Keshillit Bashkiak

Sokol Sava



Adresa: Bulevardi "ELEZ ISUFI", Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com nr.tel:00355218



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**BASHKIA DIBËR**  
**DREJTORIA EKONOMIKE**  
**(Sektori i Financës)**

2019//  
Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Peshkopi, më 28.06/2021

**Lënda :** Kthim përgjigje kërkesës tuaj nr.2019 prot datë 14.06.2021

**Drejtuar:** Këshillit Bashkiak

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.2019 prot datë 14.06.2021” Kërkesë për bashkëpunim “ në lidhje me paraqitjen e materialit për projekt buxhetin 2022 dhe atë 2022-2024 dhe prioritetet e sugjeruara gjatë realizimit të konsultimit publik të Këshillit, kërkesat e ardhura nga Shoqëria civile, Komuniteti i biznesit , media etje si dhe sic është trajtuar dhe në shkresën tuaj sqarojmë se prioritetet e komunitetit janë marrë parasysh si më poshtë :

- Bashkia Dibër ka prioritet gjatë vitit 2022 përmirsimin e infrastruktures rrugore , rehabilitimin e rrugëve egzistuese , hapje nga shembjet e dëmtime të rrugëve , urave si dhe akses të përmirësuar drejt destinacioneve turistike në teritorin e Bashkisë . Në këtë PBA për të bërë të mundur këto ndërhyrje është parashikuar fondi prej 88 milion lekë :
- Fond të vecantë për aftësi dhe kufizuar nuk kemi ze me vete por ka lehtësim tek tarifat vendore për kategoritë me AK Bashkia do bashkepunonje me donatore vendas dhe të huaja vendore për të mbështetur me karroza ortopedike një numër të konsiderueshëm personash paraplegjik, do asistohen me paketa ushqimore nga Bashkia
- Në lidhje me mbështetjen e arsimit profesional Bashkia Dibër ka paraqitur pranë ministrisë së Financave projektin për rikonstruksionin e plote të Shkolles së mesme profesionale Nazmi Rushiti.
- Në bashkëpunim dhe me ndërveprim të Bashkisë Dibër nxënësit e shkollave të mesme profesionale sipas drejtimeve të caktuara krijohen lehtësira dhe mundësi për zhvillimin e praktikave profesionale dhe më tej me perfundimin e shkolles shikohen sipas nevojave dhe mundësitë e punësimit të nxenesve që dalin nga shkollat profesionale.
- Një tjetër lehtësim dhe suport për nxënësit e shkolles profesionale janë dhe bursat që akordohen nga keshilli Bashkiak sipas kritereve
- Në lidhje me lehtësirat për bizneset e reja që hapen në Bashkinë e Dibres gjatë vitit 2022, në PBA 2022-2024 janë parashikuar që të përjashtohen nga detyrimi i pageses së tarifave bashkiake për tre muajt e parë të aktivitetit , bizneset në fushën e artizanatit, grumbullimit dhe përpunimit të prodhimeve të tekstile , bujqësore , bime medicinale, perfutojnë reduktim të taksave në masën 30% për vitin 2022, gjithashtu edhe studentet e

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Albania, nr.tel. & fax. 00355 218 229 37 e-mail: bashkiadiber@gmail.com


diplomuar ne dy vitet e fundit 2020-2021 dhe qe nisin aktivitet si biznes i vogel per periudhen 01.01-31.12.2022 do te perfitojne reduktim te detyrimeve vendore ne masen 30% nese do nisin aktivitetin ne fushen e artizanatit , grumbullimit dhe perpunimit te prodhimeve tekstile, buqesore si dhe hapjen e sallave te internetit

- Në aspektin e promovimit të zonës së Dibrës gjatë vitit 2022 do përgatiten broshura informative turistike për të gjithë zonën e Dibrës ku janë parashikuar në buxhetin e vitit 2022. Krijimi i lehtësirave për njësitë e reja akomoduese , shtëpi pritëse bujtina etj. Mbështetja e festave vjetore / aktiviteteve të cilat janë të parashikuara ne kalendarin ne fillim te vitit,
- Përmirsimi, rehabilitimi dhe rikonstruksioni i rrjetit te kanaleve vaditëse në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Dibër
- Politika lehtësuese për gratë e divorcuara apo të pamartuara me fëmijë aktualisht pasqyrohen në faktin që janë të perjashtuara nga tarifat për shërbimet që ofrohen nga Bashkia sic janë tarifa e shërbimit të pastrimit , ndricimit , apo vërtetime të ndryshme nga sektorë të ndryshëm.

Faleminderit!

Drejtor Ekonomik:

Lorenc CIBAKU



KRYETARI I BASHKISË NË DETYRË

